



KOLEGJI UNIVERSITAR “REALD”

KODI I ETIKËS

NË KOLEGJIN UNIVERSITAR “REALD”

(Miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik)

Vlorë, 2017



KREU I PERCAKTIME TE PERJITHSHME

NENI 1 BAZA LIGJORE

Kodi i Etikës në Kolegjin Universitar Reald bazohet në Ligjin Nr.80/2015, datë “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e ri të KUR.

NENI 2 QËLLIMI

Në Klegjin Universitar “Reald”, me përgjegjësinë e promovimit të një atmosfere ndershmerie akademike, me qëllimin për edukimin e gjithë komunitetit të tij, përgatit dhe miraton këtë kod etike nëpërmjet të cilit do të sigurohet që politikat e institucionit do të realizohen në përputhje me këto norma, në shërbim të integritetit dhe imazhit universitar.

Qëllimi i kodit të etikës është të sigurojë realizimin e misionit të universitetit në përputhje me parimet e deklaruara dhe vlerat e universitetit.

- Të ruajë reputacionin dhe imazhin e universitetit brenda dhe në marrëdhënie me të tretët.
- Drejtësi: Drejtësia kërkon që njerëzit të trajtohen në mënyrë të kujdesshme, të mos diskriminohen, abuzohen apo përdoren. Kjo konsiston në ndarjen dhe parandalimin e abuzimit me pushtetin. Do të thotë, gjithashtu, mundësi të barabarta dhe ndarje korrekte të përfitimeve sociale për individ. Kjo bazohet në bindjen ndaj ligjeve të shtetit.
- Respekt për të tjerët, që nënkupton njerëzit të trajtohen si individë me të drejta që duhen respektuar dhe mbrojtur, sidomos në rastet kur individët janë të pafuqishëm për të kërkuar të drejtën.
- Përgjegjësi, që do të thotë se njerëzit kryesisht kanë detyrim moral të bëjnë mirë dhe jo të dëmtojnë interesat e tjetër kujt. Për veprimet, subjektet do të mbajnë përgjegjësi.
- Të sigurojë të tretët që në marrëdhënie me universitetin, do të plotësohen standartet etike të duhura.
- Të sigurojë dhe të përdorë mekanizmat e duhura për implementimin, monitorimin dhe rishikimin e drejtimeve dhe politikave për t'i dhënë efektivitet kodit të etikës.
- Të sigurojë se parimet etike kyce janë përdorur në drejtimin e duhur.



- Të sigurojë një sjellje të mirë të anëtarëve të universitetit, në përputhje me etikën profesionale.

NENI 3 MISIONI, PARIMET DHE VLERAT

Misioni kërkon është krijimin e një komuniteti mësimi dhe kërkimi shkencor, me reputacion kombëtar, që mirëpret stafin dhe studentët nga nivele dhe nacionalitete të ndryshme, duke u bazuar në aplikimin inteligjent të njohurive, aftësive dhe teknologjisë bashkëkohore.

Në përputhje me misionin e tij Kolegji Universitar “Reald” angazhohet të marrë përsipër:

a. Parimet të jetës publike:

- Integritetin;
- Objektivitetin;
- Përgjegjshmërinë;
- Sinqeritetin;
- Ndershmërinë;
- Respektimin e hierakisë universitare.

b. Vlerat e mëposhtme:

- Të mësuarit dhe kërkimin shkencor;
- Ekselencën;
- Integritetin;
- Diversitetin social dhe kulturor;
- Risinë;
- Kujdesin dhe respektin reciprok.

NENI 4 IMPLEMENTIMI

Një radhë rregullash do të mbulojnë elementet specifike të paraqitjes së misionit. Këshilli i etikës do të marrë të gjitha masat që t'i shpërndajë dhe propagandojë të gjitha rregullat specifike të kodit të etikës, duke përfshirë këtu ëeb-siten e universitetit.



NENI 5 MONITORIMI

Komisioni i etikës do të jetë përgjegjës për të siguruar që politika e universitetit të jetë në përputhje me kodin e etikës dhe veprimtaria e tij në mënyrë periodike do t'i raportohet Senatit të Kolegjit Universitar Reald.

NENI 6 Përcaktimi

Kodi i Etikës është një bashkësi parimesh dhe rregullash që duhet të respektohet nga stafi akademik, jo akademik dhe studentët e Kolegjit Universitar Reald.

NENI 7 Subjektet dhe njohja e Kodit të Etikës

Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik dhe student është i detyruar të njohë dhe të respektojë këtë kod.

KREU II PËRBËRJA, MANDATI DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLIT

NENI 8 Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës në Kolegjin Universitar "REALD", ngrihet me Vendim të Senatit Akademik. Ky këshill ka një mandat 4-vjeçar, me të drejtë riemërimi. Këshilli i Etikës përbëhet nga 3 anëtarë, të përzgjedhur nga punonjësit akademikë të Kolegjit.
2. Këshilli i Etikës ka si funksion kryesor diskutimin e problemeve që lidhen me etikën e jetës universitare në Kolegjin Universitar "REALD".
3. Këshilli i etikës merr vendime dhe i paraqet propozime Rektorit të Kolegjit.

NENI 9 Funksionimi i Këshillit të Etikës

1. Senati akademik cakton Kryetarin e Këshillit të Etikës.
2. Këshilli i Etikës mbledhet sa herë që paraqitet një kërkesë për shqyrtim nga subjektet epërcaktuara në pikën 4 të këtij neni.



3. Kërkesa që paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Etikës përmban të paktën të dhënat e kërkesit, një përshkrim të shkurtër të çështjes së shtruar për diskutim, si edhe materiale shoqëruese të cilatshërbejnë për shqyrtimin e çështjes.
4. Këshilli i Etikës merr në shqyrtim kërkesa të paraqitura nga
 - a) Senati Akademik;
 - b) Bordi i Administrimit;
 - c) Rektori;
 - d) Zëvendësrektori;
 - e) Dekani;
 - f) Këshilli i Studentëve;
 - g) Të paktën 2 anëtarë të personelit akademik të Kolegjit.

NENI 10 **Kodi i Etikës**

1. Kodi i Etikës diskutohet nga Këshilli i Etikës dhe më pas i kalon për miratim Senatit akademik.
2. Kodi i etikës përfshin edhe rregulla më të detajuara mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Etikës, si dhe vendimmarrjet e këtij këshilli.

Është organ drejtues në universitet dhe në rastet e parashikuara në Rregullore edhe në njësitë përbërëse të tij. Këshilli i etikës ngrihet pranë universitetit dhe diskuton probleme të etikës së jetës universitare, për të cilat i bën propozime Rektorit. Mënyra e shqyrtimit të ankesave, vendimet, sanksionet përkatëse dhe ekzekutimi i këtyre vendimeve, parashikohen në rregulloren e tij.

Këshilli ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë me iniciativë informacione nga personeli akademik, ndihmës mësitor - shkencor dhe administrativ dhe njësitë përbërëse të universitetit, përveç Senatit Akademik, Rektorit dhe hallkave paralelele dhe këshillat e studentëve lidhur me respektimin e kërkesave të moralit dhe të etikës në realizim të funksioneve e detyrave të secilit.

Për rastet dhe mënyrën e verifikimeve në organet drejtuese dhe bashkëpunimit me individë, organe dhe institucione jashtë tij, Këshilli i Etikës duhet të marrë pëlqimin e Senatit Akademik e në pamundësi, të Rektorit i cili kërkon miratimin për këtë në mbledhjen më të parë, në të kundërt, konstatimet janë të pavlefshme.

Këshilli i Etikës ia paraqet konstatimet e tij Rektorit me rekomandimet përkatëse.



Kur konstatimet lidhen me personelin akademik e kur është marrë pëlqim për verifikim, Rektori vë në dijeni Senatin Akademik.

Mandati i anëtarit të organeve dhe autoriteteve drejtuese mbaron kur:

1. përfundon afati;
2. jep dorëheqjen;
3. vdes, pamundësohet nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
4. në rast shkelje të rëndë të ligjit dhe të statutit;

KREU III DETYRIMET DHE NDALESAT

NENI 11

Kodi etikë ndalon sjellje që, në kuptimin më të gjerë, mund të përshkruhen si mashtrim, kopje, a vjedhje. Shkeljet e kodit përfshijnë, por nuk kufizohen, në rastet e mëposhtme:

1. Fabrikim i të dhënave apo citimeve;
2. Bashkëpunim në çështje të ndaluara nga pedagogu;
3. Paraqitje punimi në grup të paautorizuar;
4. Pengim i punës së të tjerëve, përfshi dëmtime a manipulime të bibliotekës;
5. Vjedhje intelektuale: paraqitje si të vetën e çfarëdo pune që s'është e veta;
6. Krijim i avantazheve të padrejta;
7. Favorizim mashtrimi;
8. Ndërhyrje në të dhëna apo falsifikim i tyre;
9. Kopje në provim nëpërmjet përdorimit të materialeve të shkruara apo dhënies a marrjes së ndihmës në çfarëdo forme gjatë provimit, përfshirë komunikimin me gojë, sinjale, mjete elektronike, etj.

NENI 12

Trajtimi pa paragjykime dhe krijimi i mundësive të barabarta të punësimit është detyrim. Të gjithë drejtuesit ekzekutivë: dekanët, zv-dekanët, shefat e departamenteve, kanë përgjegjësinë për t'u kujdesur që këto parime të përkrahen në çdo kohë dhe t'ju komunikohen të gjithë personelit për të patur njohuri të plota dhe



për t'i kuptuar sa më mirë ato. Drejtuesit ekzekutivë duhet të trajtojnë brenda normave etike vartësit e tyre dhe në asnjë mënyrë të mos aplikojnë metoda dhe komunikim denigrues.

NENI 13

Anëtarët e stafit akademik dhe jo akademik studentë duhet ta trajtojnë njëri-tjetrin me mirësjellje, konsideratë dhe profesionalizëm.

Universiteti nuk do të tolerojë ngacmimin ndaj asnjë punëdhënsi, pedagogu, apo student që kryhet nga cdo anëtar tjetër i komunitetit universitar bazuar në dallimin racial, besimin, ngjyrën, kombësinë, etninë, seksin, orientimin seksual, privatësinë invaliditetin, fenë, gjendjen civile apo mbi çdo lloj çështje tjetër që mbrohet nga ligjet shtetërore. Me këtë politikë universiteti ndalon jo vetëm ngacmimet e paligjshme por gjithashtu edhe veprime të tjera joprofesionale dhe të pasjellshme. Përkatësisht, vërejtjet përçmuese apo të papërshtatshme, fyerjet apo shakatë që lidhen me faktorë të paligjshëm nuk do të tolerohen.

NENI 14

Është jo etike për anëtarët e stafit të universitetit, të pranojnë çfarëdo lloj dhurate apo përfitimi për vete, të cilat në një mënyrë apo tjetër mund të kompromentojnë apo influencojnë ata në kryerjen e detyrave të tyre.

Praktikat korruptive dhe konkretisht ofrimi, kërkimi, dhënia apo pranimi i dhuratave të jashtëligjshme dhe pagesave si dhe përfitimeve apo shërbimeve të tjera të cdo lloji për vete apo për të tretët ndalohen rreptësisht.

NENI 15

Veshja dhe paraqitja korrekte, estetike është detyrim i tërë anëtareve të komunitetit universitar.

NENI 16

Ndalohet përdorimi i pijeve alkoolike, substancave narkotike dhe duhanit në ambientet e universitetit.

NENI 17

Gjatë punës së tyre pedagogët duhet të bëjnë kujdes për të ruajtur emrin e mirë të profesionit dhe të kenë marrëdhënie korrekte me kolegët. Të punojnë në grup



dhe të respektojnë hierarkinë institucionale. Të zbatojnë urdhrat dhe orientimet me shkrim ose me gojë nga eprori.

NENI 18

Në ambientet universitare ndalohet komunikimi me zë të lartë, prishja e higjenës dhe pastërtisë si (të shkruarit në banka, në mure, hedhja e mbeturinave jashtë vendeve të caktuara, etj).

NENI 19

Deklarimet, shkrimet apo publikimet, që dëmtojnë apo denigrojnë imazhin e universitetit apo të personelit të tij, janë të ndaluara rreptësisht.

NENI 20

Anëtarët e universitetit janë të detyruar të respektojnë të drejtat e individit për privatësi dhe të trajtojnë në konfidencë të gjithë informacionin që u përket atyre mbi këtë bazë. Në veçanti, përveç kërkesave ligjore mbi të dhënat personale dhe zyrtare (të tilla si rekordet akademike) të studentëve apo stafit, nuk mund t'u jepen të tretëve pa pëlqimin e individit, të cilit ky informacion i përket.

NENI 21

Nga Anëtarët e Senatit si persona përgjegjës për një komunitet më të gjerë për drejtimin dhe menaxhimin e universitetit, pritet që gjithmonë të veprojnë në interesin më të mirë të universitetit dhe komunitetit duke u treguar:

- të përgjegjshëm dhe të arsyeshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre;
- të ndershëm dhe gjithmonë në interesin më të mirë të universitetit si një i tërë;
- dhe jo në interes të grupeve të vecanta.

NENI 22

Përdorimi nga stafi i universitetit i burimeve (ambientet, bibliotekat, laboratorët, etj.) duhet të bëhet në një mënyrë rezultative dhe ekonomike dhe njëkohësisht të mos lejohet abuzimi me këto nga të tretët.

Prona universitare nuk mund të përdoret për qëllime private me përjashtim të rasteve të aprovuara nga Rektori.



NENI 23

Anëtarë të stafit akademik të universitetit inkurajohen të kontribuojnë në debatet publike në kuadër të shqetësimeve të qytetarëve. Anëtarë të stafit që shkruajnë apo flasin në publik mund ta indetifikojnë veten si pjesë e universitetit dhe në të njëjtën kohë të bëjnë të qartë se pikëpamjet apo këndvështrimet janë personale.

Përdorimi i emrit të universitetit ne promovime apo reklama të produkteve komerciale, do të lejohet vetëm në rastet kur ky veprim është i aprovuar ose do të sjellë një përfitim direkt për universitetin.

Anëtare të stafit nuk duhet të përdorin apo të lejojnë përdorimin e emrit të universitetit pa marrë miratim paraprak për këtë.

NENI 24

Ndërhyrja në të dhëna jo vetëm personale, marrja e paautorizuar dhe fallsifikimi i tyre përbën shkelje të rëndë të Kodit të Etikës.

NENI 25

Një person që padit, ose bën një deklaratë kundrejt një anëtari të komunitetit universitar me keqbesim ose për arsye irrituese (pa baza dhe me qëllim të keq) do të ndëshkohet.

NENI 26

Çdo anëtar i stafit akademik, në rast se vihet në dijeni të një shkeljeje të kodit, ka për detyrë t`ia bëjë të ditur këtë Këshillit të Etikës.

KREU IV PROCEDURA PËR TRAJTIMIN E SHKELJEVE

NENI 27

Në rast shkeljesh të kodit të ndershmerisë akademike, këshilli vë në dispozicion anëtarë për të hetuar, ndërmjetësuar dhe nëse është tejet e domosdoshme, për të ngritur një grup dëgjimor.

NENI 28

Komisioni mund të vihet në lëvizje kryesisht ose mbi bazën e një ankese.



NENI 29

Mënyra e trajtimit të shkeljeve të raportuara është përgjithësisht progresive. Kjo do të thotë që procedura është hartuar në mënyrë të tillë që të lejojë opsione zgjedhjeje në faza të ndryshme, bazuar mbi seriozitetin e problemit apo fakteve që dalin gjatë shqyrtimit.

NENI 30

Ndonëse puna normalisht bëhet nga këshilli, siç përshkruhet këtu, administratori/kancelari ka autoritetin të mbledhë një komision për trajtimin e një akuze, kur problemi është urgjent dhe Këshilli i përhershëm e ka të pamundur të mblidhet. Në raste të tilla, administratori/kancelari përpiqet brenda të gjitha mundësive të sigurojë përfaqësim si të studentëve edhe të stafit akademik në grupin dëgjimor.

NENI 31

Kushdo student apo anëtar i stafit që vë re, apo dyshon për një shkelje inkurajohet ta raportojë shkeljen tek cilido anëtar i këshillit të etikës, apo në zyrën e rektorit, ose të kancelarit, të cilët ia transmetojnë problemin këshillit.

NENI 32

Anëtarëve të stafit u kërkohet të raportojnë direkt në zyrën e rektorit / kancelarit të gjitha rastet e pandershmërisë akademike. Kjo përfshin në veçanti ato raste, në të cilat studentit dhe profesori e zgjidhin problemin pa kërkuar ndonjë masë nga Këshilli i Etikës. Edhe pse një rast pandershmërie akademike mund të zgjidhet me një qortim të fortë, rasti duhet të regjistrohet në mënyrë që pedagogu dhe rektori të mund të kenë dijeni nëse studentit ka apo nuk ka raste të mëparshme të rregjistruara te Këshilli i Etikës. Studentët që dëshirojnë të kontestojnë pretendimet kundër tyre apo vendimin e zyrës së rektorit / kancelarit, mund të kërkojnë të dëgjohen nga grupi dëgjimor.

NENI 33

Kur Këshilli merr njoftim për një shkelje të kryer, kryetari cakton një nga anëtarët të ndërmarrë rolin e ndërmjetësuesit dhe/apo të nxjerrë në dritë faktet. Ky e fillon punën në mënyrë sa më të shpejtë e më efikase që të jetë e mundur.



NENI 34

Anëtari i KE që caktohet, kontrollon, pikësëpari, nëse studenti i akuzuar ka shkelje të regjistruara në regjistrat e këshillit që ruhen në zyrën e zv-reaktorit. Nëse studenti nuk ka shkelje të mëparshme të raportuara, personi hetues kontakton studentin e akuzuar dhe personin apo personat dyshues për studentin dhe fillon investigimin me shpresën për të gjetur arsye për ndërmjetësim. Po qe se pas investigimit del se nuk ka shkelje të mëparshme, faji nuk është tepër i rëndë, personi hetues mund të tentojë të shohë nëse palët bien dakort për faktet e çështjes dhe nëse mund të arrihet një zgjidhje që nuk do kërkonte përfshirjen e një grupi dëgjimor. Po qe se nuk arrihet një zgjidhje, kërkohet seancë dëgjimore dhe profesori vazhdon të mbledhë fakte nga gjithë palët e përfshira. Po ashtu, nëse studenti i akuzuar ka shkelje të regjistruara, kërkohet një seancë dëgjimore dhe mbledhësi i fakteve fillon investigimin me synim përgatitjen e çështjes për dëgjim.

Kur hetimi është i plotë, personi hetues bën një përmbledhje me shkrim të çështjes. Kjo përmbledhje e palëve të përfshira në shkeljen e pandehur dhe kryetarit të komisionit të etikës. Kryetari kontakton anëtarët e tjerë të komisionit, me synimin e thirrjes së një grupi dëgjimor. Kryetari mban parasysh se një vendim i komisionit kërkon shumicë të thjeshtë të të pranishmëve. Seanca dëgjimore kryesohet nga mbledhësi i fakteve, që vetë nuk voton.

NENI 35

Votimi që konfirmon një shkelje duhet të bazohet mbi të dhëna të qarta e bindëse. Nëse shumica e anëtarëve votues, votojnë se shkelja është kryer, atëherë grupi dëgjimor vijon me diskutimin për dënimin.

NENI 36

Pasi Këshilli ka shqyrtuar dënimin e mundshëm, kryetari vendos se cili duket vendimi më i arsyeshëm nga shumica.

NENI 37

Vendimet kundër një personi mund të apelojnë tek rektori, veç rrethanave të jashtëzakonshme, brenda një afati prej 7 ditësh pune nga dhënia e vendimit. Normalisht rektori merr në konsideratë vetëm apelimet që lidhen me shkelje proceduriale apo të dënimeve të paarsyeshme. Zyra e rektorit ka autorizimin të vendosë dënimin për personin në fjalë.

Një vendim i këshillit nëse nuk ka patur shkelje nuk mund të apelojë më tej.



NENI 38

Sekretari mban protokoll të seancës. Këto materiale të shkruara janë konfidenciale dhe ruhen.

Vetë procedurat dhe dënimi i pezullimit nuk bëhen pjesë e dosjes së studentit.

Me diplomimin e studentit, regjistrimi i një shkeljeje të vetme fshihet.

NENI 39

Personi që ka vënë re shkelje ka detyrimin të paraqesë një ankesë ose formular me shkrim, e shoqëruar ose jo me prova.

NENI 40

Rektori nëse sheh që ka prova të qarta dhe konkrete, merr vendimin në përputhje me Kodin e Etikës.

NENI 41

Nëse provat nuk lejojnë të konkludosh në mënyrë të domosdoshme ose janë të pamjaftueshme, rektori ia përcjell çështjen komisionit të etikës, ose mund të ngrejë një grup dëgjimor në përputhje me specifikat e problemit, i cili pasi shqyrton rastin, rezultatin ia përcjell këshillit të etikës. Ky i fundit merr vendim për masën ndëshkuese që do të aplikohet.

NENI 42

Këshilli i etikës ia përcjell vendimin rektorit të kolegjit.

KREU V

NENI 43

Masat ndëshkuese të parashikuara nga ky kod janë:

- vërejtje me shkrim;
- paralajmërim për largim nga puna;
- pezullim nga një semestër deri në një vit akademik;
- largim përfundimtar nga puna.



NENI 44

Caktimi i masave ndëshkuese në parim do të ketë karakter progresiv, përveç rasteve kur shkeljet janë të rënda.

NENI 45

Caktimi i llojit të masës ndëshkuese do të bëhet në bazë të llojit të shkeljes, intensitetit, përsëritshmërisë dhe pasojave të ardhura.

R E K T O R I

Prof. Dr. Petrit KOTORI